

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët. Shukri Sylejmani, kryetar, Emine Kaçiku dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve Xh., L., L., G., A. dhe V. R., të gjithë nga komuna Ferizaj, të cilët i përfaqëson Z. G., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurave Hekurudhat e Kosovës “Trainkos” sh.a., me seli në Fushë Kosovë dhe Komuna e Ferizajit, për kompensim dëmi, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr. 2823/13 datë 3.5.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 13 prill 2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të autorizuarit të paditësve, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr. 2823/13 datë 3.5.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, AC.nr. 2823/13 datë 3.5.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësve, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr. 413/2006 datë 6.6.2013, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve që të obligohen të paditurat solidarisht që paditësve t’iu kompensojnë dëmin material dhe jo material në shumë prej 42.000,00 €.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, i autorizuari i paditësve me kohë ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të prishen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të autorizuarit të paditësve është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datën 20.2.2006 në fshatin Nikadin-Ferizaj ka ndodhur aksidenti i rëndë trafiku, me ç'rast ka humbur jetën tani i ndjeri B. R., nga komuna Ferizaj – paraardhës i paditësve. Aksidenti ka ndodhur në atë mënyrë që deri sa i ndjeri B. R., ishte duke drejtuar veturën “O. C.”, ngjyrë të kuqe, me targa ..., në drejtimin Ferizaj – fshati Varosh, kur vjen në vendkalimin mbi hekurudhë në fshatin Nikadin, duke mos respektuar shenjën stop, nuk ndalet por tenton që ti kalojë binarët, por në ndërkohë nga drejtimi i Ferizajt në drejtim të Kaçanikut ishte duke qarkulluar treni, i cili e godet veturën e lartpërmendur në pjesën e përparme, në anën e djathtë, dhe e bartë 273 metra larg prej pikës së goditjes deri në pikën përfundimtare. Paditësit duke konsideruar se të paditurat janë përgjegjës për vdekjen e familjarit të tyre në këtë aksident hekurudhor, nga të njëjtit kanë kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material në shumën prej 42.000€.

Në një gjendje faktike të vërtetuar kësisoj gjykata e shkallës së parë ndaj të paditurës së parë, “I.” ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësve, kurse ndaj të paditurës së dytë Komuna Ferizaj, ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve duke gjetur se në bazë të provave të administruara, veçanërisht në bazë të super ekspertizës së aksidentit të komunikacionit është vërtetuar pa dyshim se gjer ke aksidenti ka ardhur ekskluzivisht për shkak të lëshimeve të ngasësit të veturës së lartpërmendur, pasi që i njëjti me të arritur në vendin përpara binarëve hekurudhor ka ndërmarrë veprimin e kalimit të binarëve pa u siguruar se këtë veprim do ta realizojë në mënyrë të sigurt, dhe këtë veprim i lartpërmenduri e ka ndërmarrë në kundërshtim me Ligjin mbi Sigurinë e Komunikacionit, pasi që në vendin ku ka tentuar t'i kalojë binarët ekziston shenja e komunikacionit stop dhe shenja e binarëve, kështu që drejtuesi i lartpërmendur i automjetit nuk është kujdesur sa duhet për sigurinë e tij. Shikueshmëria ka qenë e mjaftuar për të parë trenin nga ana e drejtuesit të veturës, si nga ana e majtë ashtu edhe nga ana e djathtë, kështu që ai nuk ka qenë i penguar nga kushtet e rrugës apo kushtet tjera që të ndërmarrë një veprim të tillë fatkeq, me të cilin ka shkaktuar aksident fatal për jetën e tij.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të autorizuarit të paditësve dhe ka vërtetuar si të ligjshëm aktgjykimin e lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të së njëjtës gjykatë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në një gjendje të tillë të çështjes pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet e tyre nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me të cilat gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK, kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Në revizion thuhet se me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësve, gabimisht është zbatuar e drejta materiale, nga se përgjegjësia e Komunës së Ferizajt është objektive meqë ajo nuk është përkujdesur që qytetarët e vet të lëvizin pa rreziqe në vendkalimin ku është shkaktuar aksidenti në komunikacion, dhe se pas këtij aksidenti komuna në këtë vendkalim ka vendosur rojtar të përhershëm të cilët lëshojnë dhe ngritin në mënyrë manuale laurën (rampën). Këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara për të njëjtat shkaqe dhe arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe asaj të dytë, të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Për më tepër në nenin 178 të LMD, në fuqi në kohën e aksidentit, parashihet që në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë. Nga kjo dispozitë rezulton se edhe në këtë aksident trafiku nuk kemi të bëjmë me përgjegjësinë objektive të Komunës së Ferizajt, pasi që përgjegjësia në këtë rast përcaktohet në bazë të fajësisë. Në rastin konkret pa dyshim, fajësia qëndron në anën e drejtuesit të automjetit, dhe në këtë drejtim edhe gjykata e revizionit pranon si të bazuar mendimin dhe konstatimin e tre ekspertëve të komunikacionit, i cili gjendet në shkresat e lëndës. Përndryshe, nuk mund të detyrohet e paditura e dytë për kompensim dëmi pasi që është provuar se dëmi është shkaktuar pa fajin e saj, kështu që nuk janë plotësuar kushtet për përgjegjësinë e të paditurës komuna e Ferizajt, të parashikuara me nenin 154 të LMD.

Për arsyet e paraqitura më lartë, dhe në pajtim me nenin 222 të LPK, revizioni i të autorizuarit të paditësve u refuzua si i pabazuar, në tërësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.42/2017, më 13 prill 2017

Kryetari i kolegjit,
Shukri Sylejmani